

VENDIM
Nr. 122, datë 18.3.2000

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.529, DATË 21.8.1998, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PROCEDURAT E TENDERIMIT TË PAKETAVE TË AKSIONEVE TË SHOQËRIVE TREGTARE, QË ZOTËROHET NGA SHTETI"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 3 dhe 23, të ligjit nr. 7512, datë 10.8.1991, "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, nismës së lirë, veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit", dhe të pikës 2 të nenit 3, të ligjit nr.8334, datë 23.4.1998, "Për privatizimin e shoqërive tregtare, që veprojnë në sektorët jostrategjikë", me propozimin e ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.529 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pika 2 në kapitullin I, ndryshohet si më poshtë:

"Vendimi i Këshillit të Ministrave për privatizimin me tender të paketave të aksioneve përcakton:

- formën e tenderit (të hapur ose të kufizuar). Në rastin e tenderit të kufizuar edhe emrat e kandidatëve, që ftohen të marrin pjesë.
- vlerën e depozitës së garancisë për pjesëmarrjen në tender, e cila caktohet në varësi të kërkesave të tenderit dhe të veprimtarisë së shoqërisë që privatizohet. Depozita e garancisë të jetë deri në 15 për qind të vlerës nominale të paketës së aksioneve, që ofrohen për shitje, por jo më e vogël se 30 000 (tridhjetë mijë) USD.
- trajtimin e dokumentacionit të tenderit në formë konfidenciale ose jo".

2. Pika 1, në kapitullin II, ndryshohet si më poshtë:

"Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave, për privatizimin me tender të paketave të aksioneve, ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit nxjerr urdhërin për përgatitjen e dokumentacionit për privatizimin me tender të shoqërisë.

3. Pika 1, në kapitullin II.1, riformulohet si më poshtë:

"Ftesa për tender publikohet në tri gazeta me qarkullim kombëtar, jo më pak se tri herë në secilën gazetë, brenda një afati 30 ditësh. Gjatë kësaj periudhe Agjencia Kombëtare e Privatizimit vendos afishe pranë shoqërisë përkatëse."

4. Shkronja "f" e pikës 4, në kapitullin II. 1, ndryshohet si më poshtë:

"Pagesën për tërheqjen e dokumentacionit të tenderit, pranë Agjencisë Kombëtare të Privatizimit, në këmbim të një deklarate me shkrim për trajtimin, në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave për konfidencialitetin."

5. Pas shkronjës "h", të pikës 4, në kapitullin II.1, shtohet shkronja "i", me këtë përmbajtje:

"Projektkontrata për shitjen e paketës së aksioneve me tender."

6. Pika 1, në kapitullin IV, riformulohet si më poshtë:

"Në ditën dhe vendin e caktuar në ftesën për tender, kandidatët do t'i paraqesin ofertat (në pesë kopje) me zarf të mbyllur, të vulosur, pa emrin e kandidatit. Çdo faqe e 5 kopjeve të ofertës duhet të ketë firmën origjinale të kandidatit (ose të autorizuar prej tij).

Dokumentacioni i paraqitur në ofertë duhet të jetë në gjuhën shqipe, ndërsa për investitorët e huaj edhe në anglisht."

7. Paragrafi i fundit i pikës 3, në kapitullin IV, riformulohet si më poshtë:

"Pagimin e çmimit të paraqitur në ofertë, sipas kontratës me Agjencinë Kombëtare të Privatizimit."

8. Pika 1, në kapitullin VI, shfuqizohet.

9. Në pikën 3, në kapitullin VII, shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

"Eksperti, i kërkuar prej komisionit të vlerësimit të ofertave, shpërblehet sipas përcaktimit të drejtorit të Agjencisë Kombëtare të Privatizimit, në varësi të detyrave që i caktohen."

10. Në fjalinë e fundit të pikës 1, në kapitullin VIII, pas "...por vetëm", hiqet fjala "kryesisht".

11. Shkronja “b”, e pikës 1, në kapitullin IX, riformulohet si më poshtë:
“Kandidati në tender ka shkelur konfidencialitetin, kur ai kërkohet në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave.”.
12. Paragrafi i dytë i pikës 2, në kapitullin IX, riformulohet si më poshtë:
“Nuk paraqitet ndonjë ofertë në kohën dhe vendin e caktuar në ftesën për tender.”.
13. Pika 3, në kapitullin X, riformulohet si më poshtë:
“Në vendimin e rezultatit të tenderit shënohet klasifikimi i kandidatëve, sipas rendit zbritës.”.
14. Në kapitullin X shtohet pika 6, me këtë përmbajtje:
“6. Pas shpalljes me vendim të Këshillit të Ministrave të fituesit, Agjencia Kombëtare e Privatizimit lëshon autorizimin për pjesëmarrësit e tjerë, që të tërheqin depozitën e garancisë.”.
15. Pika 2, në kapitullin XI, riformulohet si më poshtë:
“Elementët e kontratës për shitjen e paketës së aksioneve me tender do të përmbajnë të gjitha kërkesat e ftesës për tender dhe penalitetet përkatëse.”.
16. Në pikën 3, në kapitullin XI, bëhet ky ndryshim:
Nga “brenda 15 ditëve”, në “brenda 60 ditëve”.
17. Pas pikës 3, në kapitullin XI, shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:
“Brenda 2 ditëve pas hyrjes në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave për shpalljen e fituesit të tenderit, Agjencia Kombëtare e Privatizimit fillon negociimin me fituesin e tenderit, për kontratën e shitjes së paketës së aksioneve.”.
18. Shkronja “a” e pikës 4, në kapitullin XI, ndryshohet si më poshtë:
“nuk nënshkruhet, sepse palët nuk bien dakord.”.
19. Shkronja “d” e pikës 4, në kapitullin XI, ndryshohet si më poshtë:
“Agjencia Kombëtare e Privatizimit negocion për nënshkrimin e kontratës me kandidatin e radhës, pas miratimit nga Këshilli i Ministrave dhe pas hyrjes së vendimit në fuqi.”.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta